



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 28 tetor 2024  
Nr. ref.:RK 2569/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI93/23**

Parashtrues

**AAB CONSTRUCTION sh.p.k**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [K.DH.SH. II. nr. 425/2022], të 8 dhjetorit 2022 të Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga subjekti juridik AAB CONSTRUCTION sh.p.k., me seli në Prishtinë me pronar Arlind Buzhala (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

#### **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [K. DH. SH. II. nr. 425/2022] të 8 dhjetorit 2022 të Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komerciale), në ndërlidhje me Aktvendimin [PP. nr.

6/2021] të 27 gushtit 2021 të Gjykatës Themelore në Prizren-dega në Suharekë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 29 dhjetor 2022.

### **Objekti i çështjes**

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

### **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023 u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur, e cila ka shfuqizuar Rregulloren e punës së Gjykatës nr. 01/2018. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

### **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 28 prill 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 3 maj 2023, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente relevante në Gjykatë.
9. Më 3 maj 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR. KI93/23] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, gjyqtar raportues dhe me Vendimin [KSH. KI93/23] caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtar).
10. Më 31 maj 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
11. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Komerciale për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
12. Më 6 qershor 2023, Gjykata Komerciale dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
13. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

14. Më 28 maj 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të deklarojë kërkesën të papranueshme.

### **Përmbledhje e fakteve**

15. Bazuar në shkresat e lëndës rrethanat e rastit konkret kanë të bëjnë me një marrëveshje të arritur mes parashtruesit të kërkesës (debitori) me qendër operative në Prishtinë dhe shoqërisë OK GROUP sh.p.k., (kreditore) me qendër operative në Prizren, për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte. Kreditore dhe debitori, kishin rënë në mosmarrëveshje për shkak të kontestimit të disa faturave për shërbimet e lartcekura.
16. Më 13 korrik, 17 dhe 20 nëntor 2020, kreditore OK GROUP sh.p.k. dhe parashtruesi i kërkesës nëpërmjet postës elektronike shkëmbyen korrespondenca përkitazi me çështjen e faturave kontestuese, që kishin të bënin me trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte.
17. Më 24 nëntor 2020, kreditore OK GROUP sh.p.k., paralajmëroi parashtruesin e kërkesës se në rast se nuk paguhet borxhi i faturës kontestuese, mjetet e tyre do t'i realizonin nëpërmjet procedurave përmbarimore.
18. Më 30 nëntor 2020, pas konstatimit se parashtruesi i kërkesës, nuk kishte përmbushur detyrimin në mënyrë vullnetare, kreditore OK GROUP sh.p.k. nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar paraqiti propozim për përmbarim tek Përmbaruesi privat M.R për pagesën e borxhit prej dymbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një euro e pesëdhjetë centë (12,251.50€).
19. Më 2 dhjetor 2020, Përmbaruesi privat M.R, nxori Urdhrin përmbarimor [P. nr. 548/2020], mbi bazën e titullit ekzekutiv, gjegjësisht të faturës nr. 12/2020 të 17 nëntorit 2020, për pagesën e shumës së borxhit të lartcekur.
20. Më 9 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës, kundër Urdhrit [P. nr. 548/2020] të Përmbaruesit privat M.R, në afat ligjor parashtrroi prapësim në Gjykatën Themelore, duke e kundërshtuar faturën dhe fletëdërgesat e faturës. Në prapësim, parashtruesi i kërkesës, theksoi se menjëherë pas pranimit të faturës kontestuese në formë elektronike, në të njëjtin format ka prezantuar kundërshtimet e saj, duke theksuar se nuk kishte deponuar mbeturinat në deponinë e kreditorit dhe se të gjitha detyrimet që kishte pasur ndaj tij ishin përmbushur në kohë. Për më tepër, nga ana e parashtruesit të kërkesës ishte kundërshtuar edhe përmbytja e faturës, pasi në të nuk figuronte nënshkrimi i debitorit, me të cilin do të vërtetohej pranimi i faturës dhe afati i caktuar për përmbushjen e detyrimit.
21. Më 10 gusht 2021, Gjykata Themelore, me Vendimin [PP. nr. 6/2021], caktoi seancë dëgjimore, ku theksohet se zyrtari për qasje në dokumente publike H.M, i kishte ofruar qasje kreditorit për të gjitha paragonët e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës, si dhe fletëdërgesat me numrat 153, 154, 155, 156, 157, 159, 160, 161, 162, 163, ku të njëjtit paragonë përputhen me faturën me numër 12/2020 të 17 nëntorit 2020, për të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore. Gjykata Themelore në Prizren në të njëjtën datë, kishte bërë dhe shikimin e korrespondencave në lidhje me këtë çështje.
22. Më 27 gusht 2021, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [P. nr. 6/2021] nëpërmjet të cilit, refuzoi në tërësi si të pabazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës, duke lënë në fuqi Urdhrin përmbarimor [P. m. 548/2020] të Përmbaruesit privat M.R, deri në përmbushjen përfundimtare të detyrimit. Në arsyetim të aktvendimit të saj, Gjykata

Themelore, theksoi se "Fatura [nr.12/2020] e 17 nëntorit 2020 përbën dokument të besueshëm në kuptim të paragrafit 1 të nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), në bazë të të cilit ishte iniciuar procedura përmbarimore dhe se e njëjta është hartuar dhe lëshuar, pas pranimit të fletëdërgesave nga ana e debitorit, si dhe në të është caktuar afati partitiv prej tetë (8) ditësh për përmbarimin e detyrimit. Gjykata në fjalë këtë konstatim e bazoi në nenin 7 të LPK-së, i cili përcakton: *"Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla"*.

23. Më 2 shtator 2021, kreditori OK GROUP sh.p.k., në Gjykatën Themelore dorëzoi një parashtrësë, me të cilën kërkoi përmirësimin e gabimeve teknike.
24. Më 13 shtator 2021, Gjykata Themelore nxori aktvendim korigjues [PP. nr. 6/2021], me të cilin përmirësoi gabimet teknike, si dhe theksoi se "pika III e dispozitivit modifikohet për të ndryshuar obligimin e kreditorit për shpenzimet e procedurës së përmbarimit, duke u bazuar në nenin 13, paragrafi 4 të LPP-së, i cili thekson se *"debitori ka për detyrë që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet procedurale dhe të gjitha shpenzimet e tjera të shkaktuara gjatë procedurës së përmbarimit"*.
25. Më 17 shtator 2021, Gjykata Themelore urdhëroi parashtruesin e kërkesës që të deponojë shumën prej tetëmijë (8,000) euro, pranë kësaj gjykate, në rast të parashtrimit të ankesës në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit [C. nr. 6/2021] të 27 gushtit 2021 të Gjykatës Themelore.
26. Më 20 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit [C. nr. 6/2021] të 27 gushtit 2021 dhe Aktvendimit korigjues [PP. nr. 6/2021] të Gjykatës Themelore, me kërkesë që të njëjtit të anulohen dhe shfuqizohen.
27. Më 29 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore deponoi shumën e caktuar prej tetëmijë (8,000) euro.
28. Më 9 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës iu drejtua me një kërkesë Gjykatës Themelore, që lëndën gjegjësisht ankesën e tij ta përcjellë menjëherë në Gjykatën e Apelit për vendimmarrje, pasi që e njëjta nuk ishte dërguar edhe pse parashtruesi i kërkesës kishte bërë deponimin e shumës së caktuar nga Gjykata Themelore.
29. Më 1 gusht 2022, në përputhje me Ligjin nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale të Kosovës, u themelua Gjykata Komerciale.
30. Më 8 dhjetor 2022, Gjykata Komerciale, nxori Aktvendimin [K. DH. SH. II. nr. 425/22], përmes së cilit refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ushtruar kundër Aktvendimit [PP. nr. 6/2021] të 27 gushtit 2021 të Gjykatës Themelore, duke e vërtetuar këtë të fundit. Në arsyetimin e saj, Gjykata Komerciale, theksoi se: "Në rastin konkret, fatura përmban bazat ligjore për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, 27 dhe paragrafit 3 të nenit 29 të LPP-së, i cili përcakton se: *"Dokumenti përmbarimor i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim nëse tregon kreditorin dhe debitorin, si dhe objektin, mjetet, llojin, shumën dhe kohën e përmbarimit së detyrimit monetar"*. Gjykata Komerciale ndër të tjera vlerësoi se parashtruesi i kërkesës (debitori) nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të saj, ashtu siç përcakton paragrafi 6 i nenit 69 të LPP-së, dhe se nuk ka arsye ligjore për shtyrje apo pezullim të përmbarimit të caktuar, në kuptim të paragrafit 4 të nenit 61 dhe të nenit 71 të LPP-së.
31. Më 5 janar 2023, parashtruesi i kërkesës, parashtrroi propozim pranë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, që kjo fundit të ngrinte në Gjykatën Supreme kërkesë për

mbrojtje të ligjshmërisë, me pretendimin se Gjykata Themelore dhe ajo Komerciale, kishin bërë shkelje të dispozitave ligjore në fuqi.

32. Më 11 janar 2023, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, njoftoi parashtruesin e kërkesës se kishte pranuar propozimin e tij për ngritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, kundër Aktvendimit [PP. nr. 6/2021] të 27 gushtit 2021 të Gjykatës Themelore dhe Aktvendimit [K.DH.SH. II nr. 425/22] të 8 dhjetorit 2022 të Gjykatës Komerciale.
33. Më 27 janar 2023, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, nëpërmjet Njoftimit [KMLC. nr. 03/2023], njoftoi se kishte shqyrtuar propozimin e parashtruesit të kërkesës dhe ka arritur në përfundimin se sipas paragrafit 3 të nenit 14 të Ligjit për Gjykatën Komerciale kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk lejohet në kontestet që zgjidhen nga Gjykata Komerciale.
34. Më 31 janar 2023, parashtruesi i kërkesës e pranoi Njoftimin [KMLC. nr. 03/2023] nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

35. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Komerciale i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së.
36. Më saktësisht, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon se Aktvendimi [K. DH. SH. II. nr. 425/22] i Gjykatës Komerciale i ndërlidhur me Aktvendimin [PP. nr. 6/2021] të Gjykatës Themelore shkel të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkatësisht (i) të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor; dhe (ii) parimin e sigurisë juridike, si rezultat i divergjencës së vendimmarrjes gjyqësore.

*(i) Lidhur me pretendimin për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor*

37. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës thekson se Gjykata Komerciale nuk kishte ofruar arsyetimin e duhur lidhur me mungesën e nënshkrimit dhe vulës së fletëdërgesave të përdorura në hartimin e faturës së kontestuar, përkundër faktit se fatura në fjalë ishte kthyer apo reklamuar. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shikohen kopjet e fletëdërgesave nr. 163 dhe 162 të 2 korrikut 2020, nr. 161 dhe 160 të 1 korrikut 2020, nr. 159 të 30 qershorit 2020, dhe nr. 156 të 29 qershorit 2020, ku vërehet se fletëdërgesat në bazë të cilave është hartuar fatura nuk janë nënshkruar dhe as vulosur. Ky fakt sipas tij kishte ndikuar që të obligohet debitori, përkatësisht parashtruesi i kërkesës që të paguajë për mallin e papranuar, përfshirë kamatë-vonesat, shpenzimet e procedurës dhe ato të përfaqësimit.

*(i) Lidhur me pretendimin për cenim të parimit të sigurisë juridike*

38. Në lidhje me pretendimin për cenim të parimit të sigurisë juridike, parashtruesi i kërkesës thekson se në kërkesë ka bashkëngjitur edhe prova tjera, që tregojnë qasje divergjente të praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta, kur një faturë nuk pranohet nga debitori ose kur shuma e faturës është e kontestueshme. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës i kishte bashkëngjitur kërkesës Aktvendimin [PPP. nr. 1217/19], të 29 korrikut 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për të shërbyer si provë në mbështetje të pretendimeve të tij. Sipas parashtruesit të kërkesës mospërputhja e praktikave gjyqësore në një vend, mund të ketë ndikim në sigurinë juridike të qytetarëve të atij vendi.

39. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) të shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si dhe të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [K. DH. SH. II. nr. 425/2022], të 8 dhjetorit 2022 të Gjykatës Komerciale dhe Aktvendimin [PP. nr. 6/2021] të 27 gushtit 2021 të Gjykatës Themelore.

## **DISPOZITAT PËRKATËSE KUSHTETUESE DHE LIGJORE**

### **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.  
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.  
[...]*”

### **KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

#### **Neni 6**

#### **(E Drejta për një proces të rregullt)**

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.  
[...]*”

### **Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore**

#### **Neni 29**

#### **Dokumentet e besueshme**

*“1. Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është:  
[...]  
1.3. faturat;  
[...]  
2. Llogaritja e kamatës konsiderohet si pjesë e dokumentit të besueshëm.  
3. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.”*

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

40. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrënë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

*[...]*

### Neni 21

[Parimet e Përgjithshme]

*4. “Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*

42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e personit juridik, ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë ( shih rastin e Gjykatës [KI195/20](#), me parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jo-bançar “Monego”, Aktgjykim i Gjykatës i 19 prillit 2021, paragrafi 63; [KI41/09](#), parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
43. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

### Neni 47

(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

### Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...].”*

44. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të lartcekura, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin [K. DH. SH. II. nr. 425/2022], të 8 dhjetorit 2022, të Gjykatës Komerciale, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me Ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në përputhje me afatin e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
45. Përveç kriterëve të lartcekura, Gjykata po ashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

*“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*

46. Bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuzë dhe të paqarta” (shih, rastet e GJEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, Aktgjykim i 28 janarit 2011, paragrafi 55; [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, Vendim i 25 shtatorit 2008, dhe rastet e Gjykatës [Kl04/21](#), parashtruese Nexhmije Makolli, Aktvendim për papranueshmëri i 13 prillit 2021, paragrafi 26; dhe [Kl107/21](#), parashtrues Ramiz Hoti, Aktvendim për papranueshmëri i 21 tetorit 2021, paragrafi 53).
47. Përveç kësaj, GJEDNJ përcakton se një ankesë karakterizohet nga faktet e përfshira në të dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet në të cilat palët thirren shprehimisht (shih, rastin e GJEDNJ-së [Talpis kundër Italisë](#), nr. 41237/14, Aktgjykimi i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e cituara aty).
48. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
49. Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlidhet me pagesën e një fature të cilën parashtruesi i kërkesës kishte refuzuar ta paguaj me arsyetimin se nuk ishin kryer shërbimet e kërkuara. Në këtë drejtim, kreditori OK GROUP sh.p.k. pas paralajmërimit



paraqiti propozim për përmbarim tek përmbaruesi privat, i cili nxori Urdhrin Përmbarimor mbi bazën e titullit ekzekutiv, për pagesën e faturës në fjalë. Kundër këtij Urdhri, parashtruesi i kërkesës parashtrroi prapësim në Gjykatën Themelore, përmes së cilës kishte kundërshtuar faturën dhe fletëdërgesat e faturës, me arsyetimin se të njëjtave iu mungonte nënshkrimi dhe vula. Gjykata Themelore, përmes aktvendimit e refuzoi në tërësi si të pabazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës, duke lënë në fuqi Urdhrin përmbarimor, deri në përmbushjen përfundimtare të detyrimit, me arsyetimin se në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Përmbarimin, fatura përbën dokument të besueshëm. Më pas, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit përmes së cilës kërkoi anulimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore me propozimin që i njëjti të shfuqizohet. Pas miratimit të Ligjit për Gjykatën Komerciale rasti në fjalë kaloi për shqyrtim në Gjykatën Komerciale, e cila përmes Aktvendimit refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës duke vërtetuar si të vlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Themelore. Më tej, parashtruesi i kërkesës parashtrroi propozim për mbrojtje të ligjshmërisë në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, e cila kërkesë u refuzua si e palejuar në kontestet që zgjidhen nga Gjykata Komerciale.

50. Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e mësipërme të Gjykatës Komerciale dhe të Gjykatës Themelore me pretendimin se përmes aktvendimeve të tyre i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
51. Në vijim, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i (i) mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe (ii) shkeljen e parimit të sigurisë juridike, si rezultat i divergjencës së vendimmarrjes gjyqësore, për çështje të njëjta faktike dhe juridike.

### **I. Përkitazi me pretendimet për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së**

*(i) Përkitazi me pretendimet për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor*

52. Sa i përket të drejtës për vendim të arsyetuar, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së të cilën e ka përvetësuar edhe Gjykata, rezulton, mes tjerash, se (i) garancitë e mishëruara në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenin 31 të Kushtetutës, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre; (ii) vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë; (iii) gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, duhet të ofroj arsyje dhe arsyeime të tilla të cilat do t'ua mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës; (iv) paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së dhe neni 31 i Kushtetutës i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument; dhe se (v) nga natyra e vendimit që merr, varet nëse gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtrësive që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve (për një elaburim më të detajuar përkitazi me parimet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar shih, rastet e

- GJEDNJ-së, [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003, paragrafi 34; [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30; [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim, i 21 janarit 1999, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81; [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; si dhe rastet e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hydroenergji sh.p.k*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2022, paragrafët 113-124; dhe [KI164/23](#), [KI173/23](#), [KI174/23](#), [KI175/23](#), [KI176/23](#) dhe [KI201/23](#), parashtrues *Murat Syla, Gentian Syla, Shqipe Kelmendi, Rinor Sogojeva, Asdren Mustafaj, dhe Besnik Elshani*, cituar më lart, paragrafët 148- 150).
53. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Komerciale dhe Gjykata Themelore nuk kishin ofruar “arsyetim ose shpjegim për mungesën e nënshkrimit dhe vulosjes së fletëdërgesave të përdorura për hartimin e faturës kontestuese”, si dhe për faktin që fatura kontestuese është kthyer ose reklamuar. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Gjykata që të shikohen kopjet e fletëdërgesave nr. 163 dhe 162 të 2 korrikut 2020, nr. 161 dhe 160 të 1 korrikut 2020, nr. 159 të 30 qershorit 2020, dhe nr. 156 të 29 qershorit 2020, ku vërehet se fletëdërgesat në bazë të të cilave është hartuar fatura nuk janë nënshkruar dhe as vulosur. Ky fakt, sipas saj, ka ndikuar që të obligohet debitori, përkatësisht kompania që të paguajë për mallin e papranuar, përfshirë kamatë-vonesat dhe shpenzimet e procedurës dhe të përfaqësimit.
54. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht i referohet Aktvendimit [PP.nr.6/2021] të Gjykatës Themelore, e cila arsyetoi: “... se *Fatura nr.12/2020 e datës 17.11.2020, paraqet dokument të besueshëm në mbështetje të nenit 29, paragrafi 1, nenparagrafi 1.3 i Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore. Këtë faturë, Gjykata e vlerëson të përshtatshme për përmbarueshmëri pasi që për Gjykatën e njëjta i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 29, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, si dhe Gjykata vlerëson se kreditori i propozimit, mjaftueshëm i ka dëshmuar Gjykatës se mbi bazën e çfarë raportit është hartuar e njëjta. Gjykata me kujdes shqyrtoi të gjitha pretendimet dhe kundërshtimet e debitorit të ngritura në prapësim, mirëpo të njëjtat i vlerëson irelevante për vendosje, pasi që debitori i propozimit nuk ka bashkëngjitur asnjë provë materiale përmes të cilave do t'i vërtetonte pretendimet e veta. Në fund, Gjykata Themelore, theksoi: “ Detyrimi për t'i bazuar në fakte të gjitha pretendimet që i ngritin palët në procedurë e parasheh edhe neni 7 i LPK-së, dhe atë: "Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha aktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”.*
55. Në vijim, Gjykata i referohet aktvendimit të kontestuar [K.DH.SH.II.nr.425/22] të Gjykatës Komerciale, e cila përkitazi me konstatimet e Gjykatës Themelore, theksoi se: “*Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata (Themelore) ka theksuar se fatura nr.12/2020 e datës 17.11.2020 paraqet dokument të besueshëm në kuptim të nenit 29.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe se në kuptim të këtij dokumenti të besueshëm është iniciuar procedura dhe se e njëjta është hartuar dhe lëshuar, pas pranimit të fletë-dërgesave nga ana e debitorit, si dhe në të është caktuar afati partitiv prej 8 ditësh për përmbushjen e detyrimit”.*
56. Tutje, Gjykata Komerciale, theksoi se: “... Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar ka konstatuar drejt faktin se fatura nr.12/2020 dt.17.11.2020 është hartuar mbi bazën e fletëdërgesave 153, 154, 155, 156, 157, 159, 160, 161, 162 dhe 163 të datës 27.06.2020, 29.06.2020, 30.06.2020,

01.07.2020, 02.07.2020, andaj në bazë të kësaj fature organi përmbarues ka caktuar përmbarimin, (që) është dokument i besueshëm e kjo parashihet në nenin 29, paragrafi 1 të LPP-së, ku ceket se: "përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm sipas këtij ligji është edhe fatura".

57. Sa më lart, Gjykata vëren se Gjykata Komerciale kishte pranuar në tërësi konstatimet e Gjykatës Themelore, si përkitazi me faktet e vërtetuara po ashtu edhe për sa i përket bazës ligjore të aplikuar në rrethanat e rastit konkret. Gjykata vëren se Gjykata Komerciale kishte adresuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura nëpërmjet ankesës, duke i dhënë të njëjtit përgjigje në çdo pretendim thelbësor. Në lidhje me kriteret ligjore që e bëjnë një dokument të besueshëm Gjykata Komerciale, mes tjerash, arsyetoi: "... kjo gjykatë analizoi pretendimet e debitorit në prapësim, por pranoi përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sepse vlerësoi se debitori nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij ashtu siç parashihet me nenin 69, par.4 të LPP-së si dhe vlerësoi se nuk ekzistojnë as arsyet ligjore për shtyrje apo pezullim të përmbarimit të përcaktuara me dispozitat ligjore nga neni 61, par.4 të LPP-së e as nga neni 71 të LPP-së".
58. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Komerciale, kur i referohet faturës si dokument i besueshëm, këtë konstatim e bazon në kushtet e përcaktuara me ligj, gjegjësisht në dispozitat përkatëse të LPP-së, duke theksuar se: "Në rastin konkret, fatura përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit konform nenit 21, 27 si dhe nenit 29 paragrafi 3 të LPP-së, i cili thotë se: "Dokumenti përmbarimor i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar".
59. Në vlerësimin e Gjykatës, konkluzionet e Gjykatës Komerciale janë të qarta dhe të arsyetuara, të cilat nuk bien ndesh me standardin e një vendimi të arsyetuar. Për më tepër, Gjykata rikujton se paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së nuk kërkon që në instancë përfundimtare të gjyqësorit të rregullt, në rastin konkret Gjykata Komerciale, të japë arsyetim më të detajuar, kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore për refuzimin e një ankese, duke konsideruar se ajo ankesë specifike nuk ka një perspektivë për sukses (shih rastet e GJEDNJ-së [Burg dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 34763/02; vendim i 28 janarit 2003; [Gorou kundër Greqisë](#) (nr. 2), nr. 12686/03, vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41; shih rastin e Gjykatës [K1106/22](#), me parashtrues *Driton Fetahu*, Aktvendim i 8 shkurtit 2023, paragrafi 45-56).
60. Thënë këtë, Gjykata konsideron se aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Komerciale është në pajtueshmëri me kërkesat e paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës dhe të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, meqë aktvendimi, si i tillë, përmban lidhje logjike ndërmjet bazës juridike të aplikuar, arsyetimit dhe përfundimeve të nxjerra.
61. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë pretendime që i takojnë kategorisë së pretendimeve "të pambështetura apo të paarsyetuara", dhe si të tilla, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
- (ii) *Përkitazi me pretendimin për cenim të parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës së praktikës gjyqësore në vendimmarrje*
62. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Komerciale dhe Gjykata Themelore, përmes aktvendimeve të tyre, kanë cenuar parimin e sigurisë

juridike si rezultat i divergjencës së praktikës gjyqësore në vendimmarrje për çështje të njëjta faktike dhe juridike.

63. Përkitazi me parimet themelore që ndërlidhen me konsistencën e praktikës gjyqësore, Gjykata rikujton se praktika gjyqësore e saj dhe ajo e GJEDNJ-së ka rezultuar në katër parime themelore që karakterizojnë analizën lidhur me konsistencën e praktikës gjyqësore, dhe atë si në vijim: (i) siguria juridike është e mishëruar në të gjitha nenet e KEDNJ-së dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe përbën një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit; (ii) nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore; (iii) divergjenca nuk është domosdoshmërisht në kundërshtim me KEDNJ-në; dhe (iv) përveç rasteve të arbitraritetit të dukshëm, nuk është detyrë e saj të vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendas nga ana e gjykatave vendore (për një elaborim më të detajuar të parimeve të lartcekura, shih rastet e GJEDNJ-së [Borg kundër Maltës](#), nr. 37537/13, Aktgjykim i 12 prillit 2016, paragrafi 107, [Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë](#), nr. 13279/05, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafët 51, 53 dhe 56; dhe rastet e Gjykatës [KI42/17](#), parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 dhjetorit 2017, paragrafi 33-38; [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 marsit 2021, paragrafët 55 -61 dhe [KI76/22](#), parashtrues *Admir Salih*, Aktvendim për Papranueshmëri i 12 prillit 2023, paragrafi 54-61).
64. Gjykata më tej thekson se GJEDNJ në zhvillimin e parimeve themelore përmes praktikës së saj gjyqësore, praktikë e përvetësuar edhe nga Gjykata, ka vendosur tri kriteret themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e pretenduar përbën shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, si në vijim (i) nëse divergjencat në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, [Beian kundër Rumanisë](#), nr. 30658/05, Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; [Famullia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 76943/11, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafët 116 - 135; [Jordan Jordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#), nr. 23530/02, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; [Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë](#), nr. 13279/05, Aktgjykimi i 20 tetorit 2011, paragrafi 53; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, [KI175/20](#), *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi i 26 marsit 2021, paragrafi 60) dhe [KI76/22](#), parashtrues *Admir Salih*, cituar më lart, paragrafi 60).
65. Lidhur me rrethanat e rastit konkret, Gjykata sërish rithekson se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Komerciale dhe Gjykata Themelore, kanë cenuar parimin e sigurisë juridike për shkak të qasjes jo konsistente në vendimmarrje për çështje të njëjta faktike dhe juridike. Megjithatë, Gjykata vë në fokus se parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimit të saj për qasje jo konsistente në vendimmarrje gjyqësore, i ka bashkëngjitur kërkesës së tij 1 (një) Aktvendim [PPPNr.1217/19] të 29 korrikut 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ku kjo e fundit kishte vendosur, si në vijim: “*Andaj, gjykata në rastin konkret përcakton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat në kuptim të nenit 43 par. 4 të LPP-së, ngase dokumenti i besueshëm mbi bazën e të cilit është nxjerrë urdhri Përmbarimor nuk është pranuar dhe nënshkruar nga debitori i përmbarimit për ta pasur këtë cilësi në këtë procedurë dhe se me këtë rast nuk janë plotësuar kushtet e parapara me nenin 29, par. 1 nënpar. 1.1 dhe par 3, lidhur me nenin 3 të LPP-së, që kjo faturë të paraqitet si dokument i besueshëm, në këtë kuptim gjykata e pranoi prapësimin e debitorit konform nenit 71, par. 1 nënpar. 1.1 të LPP-së*”.
66. Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të saj, rithekson se nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse

merren në procedura dukshëm të ngjashme, pasi që pavarësia e tyre duhet të respektohet. (shih, rastin e GJEDNJ-së [Adamsons kundër Letonisë](#), cituar më lart, paragrafi 118, shih po ashtu rastet e Gjykatës [KI87/18](#) dhe [KI35/18](#), të cituara më lart).

67. Për më tepër, parashtruesi e kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikë gjyqësore, duhet t'i paraqesin Gjykatës argumente përkatëse përkitazi me ngjashmëritë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse të cilat mund të kenë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. (shih, rastin [KI35/18](#), cituar më lart, paragrafi 76).
68. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet jurisprudencës së GJEDNJ-së, e cila përcakton se është përgjegjësi e autoriteteve vendore për të organizuar sistemin juridik në atë mënyrë që të shmangen vendimet kundërthënëse, sidomos një kërkesë e tillë është më fuqishme kur kundërthëniet e praktikës gjyqësore nuk janë një incident (rast) i izoluar, por kjo jokonsistencë mund të afektojë një numër më të madh të personave që paraqiten në gjykatë (shih, GJEDNJ, rastin [Famullia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 129).
69. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se, bazuar edhe në praktikën e saj gjyqësore, nuk është e mundur të konstatohet ekzistimi i *“dallimeve të thella dhe të vazhdueshme”* në praktikën gjyqësore të Gjykatës Komerciale dhe Gjykatës Themelore që cenojnë parimin e sigurisë juridike, duke u thirrur në 1 (një) aktvendim të Gjykatës Themelore (shih, rastet e Gjykatës [KI29/17](#), parashtrues *Adem Zhegrova*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 shtatorit 2017, paragrafi 58 dhe [KI164/23](#), [KI173/23](#), [KI174/23](#), [KI175/23](#), [KI176/23](#) dhe [KI201/23](#), parashtrues *Murat Syla, Gentian Syla, Shqipe Kelmendi, Rinor Sogojeva, Asdren Mustafaj, dhe Besnik Elshani*, cituar më lart, paragrafi 166).
70. Gjykata, gjithashtu rithekson se bazuar në standardet e evoluimit të praktikës gjyqësore, përsërit që vendimmarrja e gjykatave të rregullta është dinamike, dhe ajo mund ndryshojë, duke iu përshtatur rrethanave të reja si dhe duke përmirësuar administrimin e drejtësisë. Është në diskrecionin dhe autoritetin e tyre për të vlerësuar dhe interpretuar të drejtën pozitive.
71. Andaj, bazuar në atë çka u tha më lart, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, për shkak të cenimit të parimit të sigurisë juridike si rezultat i jokonsistencës në vendimmarrje gjyqësore i takon kategorisë së pretendimeve *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*, dhe si e tillë, është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
72. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të deklarohet në tërësi e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 28 maj 2024, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

  
Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Gresa Caka-Nimani